

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Rama shkoi në Prishtinë për t'i bërë presion Kosovës", Peka: Gjykata Speciale u krijua nën trysni ndërkombëtare
ADRESA	https://piranjat.al/politike/intervista-ne-syri-tv-rama-shkoi-ne-prishtine-per-ti-bere-p-resion-kosov-i104498
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:34:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:31:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e257e00db0cd84f79709c995938fe2bcc7cc1f7c7870ea66da5e19c4386fdb10
TEKSTI	3036b64d1690ea2d4037fe14a7c5d192c803d73e72cf207aa211f458858bce3e
PAMJA	9c42479bc5151f455594cac4a5351ae9b47849d569b1f0b7e140dfbccf4d0244

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e116ba637e14566cad5edc6132d76a83e93015e4997374bd74896aa163ea3981
E MËPARSHMJA	632b9a091e4fa1135450299810de52cb2ddc18721cb4277ce4c0142ae24953d8
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e116ba637e14566cad5edc6132d76a83e93015e4997374bd74896aa163ea3981>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Dyshohet se ka hequr** Eno Agasi është ■ **pas dënimit të** për misionet të posaçme, Richard Grenell, reagoi ■ **i norvegjezit** vazhdojnë të qarkullojnë, ndërsa ■ **edhe Olta Xhaçkën: O** Ballën, protestuesit këtë herë ■ **që dënoi me 81** gjykes në çështjen ■ **vitet**

[POLITIKE](#)

"Rama shkoi në Prishtinë për t'i bërë presion Kosovës", Peka: Gjykata Speciale u krijua nën trysni ndërkombëtare

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 18:31



I ftuar në edicionin e pasdites në Syri TV, Avenir Peka, Ekspert Sigurie, deklaroi se Gjykata Speciale e Kosovës është ngritur si rezultat i presionit ndërkombëtar dhe se, sipas tij, nuk kishte nevojë juridike apo politike për krijimin e një gjykate të re.

Peka solli në vëmendje faktin se krimet e luftës në Kosovë ishin hetuar më herët nga mekanizma ndërkombëtarë, duke përmendur Gjykatën për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, si dhe strukturat e drejtësisë të administruara nga Kombet e Bashkuara në Kosovë.

Sipas tij, edhe çështjet ndaj ish-drejtuësve të UÇK-së, përfshirë Ramush Haradinajn dhe Fatmir Limajn, ishin trajtuar nga këto institucione.

Peka u ndal veçanërisht te pretendimet për "Shtëpinë e Verdhë", libri i Carla Del Pontes dhe raporti i Dick Martit, duke argumentuar se këto pretendime ishin në origjinën e debatit që çoi më pas drejt krijimit të Gjykatës Speciale.

Ai tha se raporti i Clint Williamson në vitin 2014 rrëzoi pretendimet për "Shtëpinë e Verdhë", ndërsa pas kësaj, sipas Pekës, Kosova u përball me presion ndërkombëtar për ngritjen e një gjykate të re.

Në këtë proces, ai përmendi edhe rolin e Shqipërisë dhe të kryeministrit Edi Rama, duke kujtuar vizitën e Ramës në Prishtinë dhe presionin për miratimin e ndryshimeve kushtetuese që i hapën rrugë krijimit të Gjykatës Speciale.

Pjesë nga intervista:

Unë gjithmonë e kam parë si një gjykatë politike dhe nga një gjykatë politike nuk mund të presësh gjë. Nëse i rikthehesh historikut të krimit të kësaj gjykate, por edhe në tërësi hetimit të krimeve të kryera gjatë luftës në ish-Jugosllavi, kupton që krijimi i kësaj gjykate nuk bën sens. Janë dy komponentë që duhet të trajtohen: e para, mënyra se si u ngritën akuzat dhe e dyta, evolimi i gjykatave. Ju e dini që ka operuar një gjykatë tjetër, që ka qenë gjykata për krimet e luftës në ish-Jugosllavi, e cila është themeluar në '92 dhe ka trajtuar krimet e luftës në ish-Jugosllavi, që përfshinte Kosovën. Ju e dini që Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj etj. janë gjykuar nga gjykata dhe fatmirësisht janë shpallur të pafajshëm.

Paralelisht me këtë gjykatë, me marrjen e Kosovës gjatë luftës nën administrim nga Kombet e Bashkuara, u ngrit sistemi gjyqësor, i cili drejtohej nga Kombet e Bashkuara, dhe ato gjykata e kanë bërë hetimet e plota me qindra raste të krimeve të kryera para, gjatë dhe gjatë luftës në Kosovë.

Pasi mbaroi mandati i asaj gjykate, u krijua gjykata e UNMIK-ut, po ashtu gjykatë ndërkombëtare, dhe ajo është marrë me hetimet e krimeve të kryera në Kosovë para, gjatë dhe pas luftës. Me mbarimin e mandatit të gjykatës së UNMIK-ut, u krijuan institucionet kosovare, sistemi i gjykatave që kanë edhe sot.

E para, në këtë këndvështrim, nuk kishte nevojë asnjë bazë juridike apo politike për krijimin e një gjykate të re. Por pse u krijua kjo gjykatë e re? Pikënisja e parë ishte libri i Carla Del Pontes të pranverës 2008, ku u ngritën pretendimet për ekzistencën e Shtëpisë së Verdhë, që quhej të ishte një ambient privat në Shqipëri, që pretendohet se ishte përdorur nga UÇK-ja për vrasjen e personave të kapur, të civilëve, ushtarakeve dhe marrjen e organeve të tyre për trafik.

Mbi këtë libër, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, 2010–2011, miratoi një rezolutë, caktoi një prokuror zviceran dhe të bënte një raport për pretendimet e ngritura nga Carla Del Ponte. Libri i Carla Del Pontes dhe raporti i Dick Martit ishin bazuar në informacione të dhëna nga institucionet serbe të sigurisë, prokuroria serbe, por edhe siguria serbe.

Raporti i Dick Martit, i cili u publikua në 2011, mbështeste pretendimet e Carla Del Pontes që kishte pasur një Shtëpi të Verdhë ku ishte bërë heqja e organeve dhe trafiku i organeve. Nisur nga ky raport, Bashkimi Europian në 2011 krijoi një grup hetimor të drejtuar nga një ish-prokuror amerikan, i cili kishte punuar edhe në Kosovë. Kishte qenë drejtor i Departamentit të Drejtësisë në Kosovë, i cili në vitin 2014 krijoi një raport 7-faqesh, ku hidhte poshtë pretendimet për Shtëpinë e Verdhë.

Në këtë moment, raporti i Dick Martit, rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, libri i Carla Del Pontes binin poshtë. Çfarë ishte për të hetuar ishin gjykatat që kishin hetuar më përpara.

Në këto kohë filloi presioni. Pas miratimit filloi presioni ndaj Kosovës për krijimin e një gjykate që tashmë do hetonte krimet që nuk ishin fokus i pretendimeve të Dick Martit, sepse fokusi i pretendimeve ishin Shtëpia e Verdhë dhe trafiku i organeve.

Me raportin e Kris Williamson të 2014, këto pretendime binin. Faktori ndërkombëtar i bëri presion Kosovës, Shqipëria u bashkëngjiti presionit ndaj Kosovës. Iu kujtohet Edi Rama, shkoi në Prishtinë, udhëtoi me helikopter nga Tirana për t'u bërë presion institucioneve të Kosovës, por edhe Parlamentit të Kosovës, për ta miratuar këtë gjykatë.

E ndodhur në këtë presion, Kosova vendosi t'i bëjë ndryshimet kushtetuese që lejonin ngritjen e gjykatave speciale, pastaj miratoi edhe ligjin për ngritjen e gjykatave speciale si pjesë e institucioneve të Kosovës. U vendos që të ishte në Hagë, për arsye se konsiderohej e rrezikshme dhe mund të ndikonte në ecurinë e gjykatës. U financua edhe nga buxheti i partnerëve ndërkombëtarë, gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit u përzgjedhën ndërkombëtarisht.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 16 Shtator18:08

[BIRN: Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magistratëve](#)

Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kundërshtuan të mërkurën më 16 shtator projektligjin e ri për pagat e magj...

POLITIKE 16 Shtator17:56

["Zgjohet" Lulzim Basha dhe reagon për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së](#)

Nga Lulzim Basha Vendimi i gjykatës speciale është një goditje për të gjithë shqiptarët. Dënimet e shqiptuara ndaj...

POLITIKE 16 Shtator16:36

[PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë](#)

Partia Demokratike ka ripërsëritur kërkesën që Kuvendi i Shqipërisë të miratojë një rezolutë për d...

POLITIKE 16 Shtator15:59

[Nesër shpallet vendimi për Ilir Metën, ish presidenti: Nuk kam munguar asnjëherë në gjyq](#)

Është mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit të Posaçëm, me relatore gjyqtaren e posaçme Saida Dollani, një proces...

POLITIKE 16 Shtator15:49

[Vendimi i Hagës/ Berisha: Thirrja jonë është për vetëpërmbytje! Emocionet nuk duhet të ndikojnë në stabilitetin e Kosovës](#)

Partia Demokratike reagoi kundër vendimit të Gjykatës së Hagës dhe dënimit të ish-drejtuësve të UÇK. Në mble...

POLITIKE 16 Shtator15:30

[Pas Ballukut dhe Ballës, protestuesit kapin “mat” në rrugë edhe Olta Xhaçkën: O hajdute...](#)

Pasi kanë kapur mat në rrugët e Tiranës Belinda Ballukun dhe Taulant Ballën, protestuesit këtë herë janë për...

POLITIKE 16 Shtator14:22

[“I ka çmendur hajnia”/ Denoncon Berisha: Aeroportin e Vlorës do ia japin Yeffetit! Agasi ka hequr 4 ministra dhe...](#)

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka hedhur akuza të forta ndaj qeverisë gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së&e...

POLITIKE 16 Shtator13:52

[“Festë në Serbi! U shqyrtuan dosjet e Beogradit”/ Berisha: Ditë e rëndë për shqiptarët, vendimi i Hagës nuk mund ta errësojë luftën e UÇK-së](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e ka nisur mbledhjen e grupit parlamentar duke komentuar aktgjykimin e Gjykatës Speciale në Hagë&e...

POLITIKE 16 Shtator11:55

[Gjykata e Hagës dënoi ish-krerët e UÇK-së, reagon Rama: Marre!](#)

Pasi Gjykata e Hagës dënoi me burg ish-krerët e UÇK-së, ka reaguar kryeministri Edi Rama. Përmes një reagimi në rrj...

POLITIKE 16 Shtator09:47

[OCCRP: ‘Revolucioni i Flamingove’ përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për Edi Ramën](#)

Protestat e shkaktuara nga një resort luksoz i diskutueshëm hyjnë në muajin e tyre të katërt, duke u përshkallëzuar n&e...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Nje e katerta e te punesuarve qe derdhen kontributin e pare me page deri ne 50 mije leke ne muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)


Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.